



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 shkronja c), nenit 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29. 01. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës, miratojë këtë :

#### **VENDIM**

#### **PËR ANULIMIN E PJESËRISHËM TË VENDIMIT 1NR.464-123 TË DT.20.06.2006 DHE SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1-464-157 TË DT.26.07.2006 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK KONJUH**

##### **Neni 1**

ANULOHEK pjesërisht Vendimi 1Nr.464-123 të dt.20.06.2006 i Kuvendit Komunal Lipjan për aprovimin e raportit të punës së komisionit për vlerësimin e konkursit publik për dhënie të tokës komunale në shfrytëzim afatgjatë në komunën e Lipjanit dhe SHKËPUTET Kontrata 1-464-157 dt.26.07.2006 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme P-71409036-00164-15 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 13000m<sup>2</sup>, (një hektar e tridhjetë ari) ZK Konjuh në pronësi të komunës, e lidhur në bazë të Vendimit 1Nr.464-123 të dt.20.06.2006 ndërmjet komunës së Lipjanit e përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës Xhevat Olluri dhe ish menaxheri i prokurimit Shensi Azemi (në tekstin e mëtejme-Komuna) si dhënësi i tokës ndërtimore në shfrytëzim afatgjatë dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore NTPSH "SADOVINA" me seli në Viti përfaqësuar nga Nexhat Fetahu (në tekstin e mëtejme-investitori).

##### **Neni 2**

Anulimi i pjesërishtëm i Vendimit 1Nr.464-123 të dt.20.06.2006 dhe shkëputja e Kontratës 1-464-157 dt.26.07.2006 bëhet për arsye se shfrytëzuesi i tokës ndërtimore NTPSH "Sadovina" nuk e ka përmbushur detyrimin kryesor-funksionalizimin e objektit "Fabrikë për prodhimin e profileve të çelikut, karrocave të dorës, gypave, valorizimin e llamarinës së zingtuar dhe kuposjes së llamarinave" që rrjedhë nga neni 5 par.5.2 i kontratës, ndërsa në par.5.2.1 përcaktohet se afati 3 vjeçar fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së lejes ndërtimore, ky afat 3 vjeçar sipas par.5.3 nënkupton edhe periudhën kur objekti duhet të lëshohet në përdorim dhe të filloj veprimtaria afariste" ashtu siq ka qenë i obliguar me kontratë.

##### **Neni 3**

Obligohet shfrytëzuesi i tokës ndërtimore NTPSH "Sadovina" që në bazë të detyrimeve kontraktore të cekura në par.11.3 të nenit 11 të kontratës 1-464-157 dt.26.07.2006 në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi ta kthen ngastrën kadastrale nr 00164-15 në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e tij.

#### Neni 4

Obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër, që të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për ndryshimin-heqjen e të drejtës së shfrytëzimit nga NTSH "Sadovina" të ngastrës kadastrale 00164-15 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 13000m<sup>2</sup>, të evidentuar në Certifikatën nr.05/2016 ZK Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzim 99 vite NTSH "Sadovina" dhe kthimin e saj në librat publike P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN (siq ka qenë para dhënies së tokës në shfrytëzim).

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso- juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

#### Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-5849  
Lipjan, më 01. 02. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT  
Vlora Zimani-Hajruni

